



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 11 prill 2012

**DEKADA E PËRFSHIRJES SË ROMËVE 2005 – 2015**

**KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR TRAJTIMIN E  
PROBLEMEVE TË PERSONAVE PA DOKUMENTE DHE PA QASJE  
NË TË DREJTAT E TYRE**

**11 prill 2012  
Holidej In**

Fjalim

Ekselencia e tij Z. Aivo Orav,  
Shef i Delegacionit të Bashkimit  
Evropian

**Të nderuar ministra, ambasadorë, përfaqësues të komunitetit  
ndërkombëtar,  
Zonja dhe zotërinj,**

Kam nderin t'u drejtohem në këtë ngjarje të rëndësishme, e cila  
organizohet në suaza të Dekadës Rome.

Bashkimi Evropian është këtu që t'ofrojë mbështetjen e vet për ju.

Politikat tona ndihmojnë inkurajimin e përfshirjes dhe integrimin e  
romëve, përmes masave të ndryshme në fusha të ndryshme. Fondet e  
Bashkimit Evropian janë mekanizmat kryesorë të financimit që përkrahin  
integrimin socio-ekonomik të romëve.

Vitin e kaluar, Bashkimi Evropian organizoi një varg konferenca lidhur  
me integrimin e romëve në vendet e Ballkanit Perëndimor. Më vjen mirë  
që Qeveria organizoi takimin e parë pauses në rajon.

Ky takim u përqëndrua në rekomandimet që kanë të bëjnë me  
punësimin, personat pa dokumente, refugjatët, strehimin, infrastrukturën  
dhe arsimimin. Takimet e këtilla janë mundësi e shkëlqyer për një  
shqyrtim të përgjithshëm të rekomandimeve të politikës dhe për  
këmbimin e informatave lidhur me progresin.

Unë përgëzoj përpjekjen e Qeverisë për zbulimin e personave pa numra  
personalë të identifikimit – pa letër njoftime.

Romët kanë qënë dhe do të mbeten prioritet i Bashkimit Evropian. Ne  
jemi duke mbikqyrur dhe vlerësuar situatën e komunitetit rom në kriteret  
politike të raportit të Progresit. Mund ta keni vënë re deri më tani se

Bashkimi Evropian ka shënuar një ngadalësim të madh në implementimin e Strategjisë nacionale të romëve gjatë viteve të kaluara.

Në të gjitha vendet nevojiten masa më efektive për integrimin e romëve. Në raportet e Progresit të publikuara për vendet nga të cilat vini ju, Bashkimi Evropian është shumë specifik lidhur me implementimin e politikave të romëve dhe shtron shqetësime serioze që kanë të bëjnë me statusin social dhe ekonomik të romëve.

Zonja dhe zotërinj

Përfshirja e romëve është në interesin e të gjithëve. Në këto kohëra sfiduese për fushën dhe aspektin ekonomik dhe financiar, duhet të rikujtohem se zhvillimi përfshirës mbetet parakusht për suksesin e përgjithshëm të Evropës në tejkalimin e krizës.

Ne mund ta tejkalojmë krizën dhe të arrijmë rritje të përfshirjes nëse mundësojmë punësimin, arsimimin, luftimin e varfërisë dhe ndërtimin e shoqërisë kohezive.

Mirëpo, progresi i vërtetë në terren varet nga involvimi i drejtëpërdrejtë i vet romëve në të gjitha nivelet e përpilimit dhe implementimit të politikës. Romët duhet të bashkojnë fuqitë pa marrë parasysh se cilës organizate të shoqërisë civile apo partie lokale politike i takojnë. Ata duhet poashtu të llojnë te autoritetet lokale dhe nacionale për të marrë parasysh problemet e tyre gjatë përgatitjes së strategjive dhe reformave nacionale.

Më lejoni të nënvizoj rëndësinë e veçantë të unitetit të liderëve politikë romë dhe shoqërisë civile, në rrugën drejt përmirësimit të situatës së komunitetit rom.

***Thank you, Blagodaram, Oven saste, Falemnderit***